



ABA RULE OF LAW INITIATIVE

**Shoqata e Gjykatësve të Kosovës
Vlerësim Organizativ 2007**

**Udruženje Sudija Kosova
Organizaciona Procena 2007**

**Kosovo Judges Association
Organizational Assessment 2007**

**ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit – Kosovë
David Sip, Drejtor
28 Maj, 2007**



Shoqata e Gjykatësve të Kosovës Vlerësim Organizativ 2007

ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit – Kosovë
David Sip, Drejtor
28 Maj, 2007



Shoqata e Gjykatësve të Kosoves Vlerësim Organizativ 2007

Nga

ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit – Kosovë

David Sip, Drejtor¹

28 Maj, 2007

Përmbledhje Ekzekutive

Objektivi i këtij vlerësimi është që nëpërmjet intervistave informative kyçe dhe grupeve të fokusimit duke përdorur pyetësor me kapacitet organizativ të standardizuar të matet kapaciteti organizativ i Shoqatës së Gjykatësve të Kosoves (SHGJK)

Katërdhjetë gjykatës, 2 nga stafi i SHGJK-së dhe të tjerë individë të interesuar ishin intervistuar nga mesi i muajit Mars dhe Maj, 2007. Të gjithë të intervistuarit kyç kanë folur mirë për shoqaten e gjykatësve, dhe kur janë pyetur për përfitimet nga anëtarësia, në mënyrë të qartë kanë definuar disa përfshirë këtu: pranimi i Buletinit, mundësija për të marrë pjesë në seminare/trajnime/udhëtime studimore dhe mësim profesional si dhe mundësi zhvillimi për ngritje të profilit të tyre profesional. Dhe për më shumë të gjithë kanë shprehë dëshirë që SHGJK-ja seriozisht të konsideroj shqetësimet e tyre dhe të zhvilloj një agjendë agresive të avokimit që do të kishte për qëllim adresimin e këtyre shqetësimeve – në mënyrë të qartë ishte shprehur se kjo duhet të jetë prioritet i SHGJK-së. Pagat e ulta, përfitimet shumë të ulta apo inekzistente, pa pensione apo kujdesje shëndetësore janë qështjet më së shumti të shprehura nga të intervistuarit. Anëtarët besonin se kur është e nevojshme dhe e përshtatshme SHGJK-ja dhe Këshilli Gjyqësor i Kosoves KGJK duhet të bashkohen forcat dhe të luftojnë për përmirësimin e këtyre gjërave pra kushtet e gjykatësve. Shumica e të intervistuarve theksuan se rregullisht e paguanjnë anëtarësinë, dhe se shumica është e vogël dhe simbolike. Shumica thanë se do të paguanin më shumë nëse SHGJK-ja do të mund të demonstronte efektivitetin e saj si një shoqatë e avokimit që do të përfaqësonte më së miri interesat e tyre.

Hyrje

Objektivi i këtij vlerësimi është që nëpërmjet intervistave seriale informative kyçe dhe grupeve të fokusimit duke përdorur pyetësor me kapacitet organizativ të standardizuar të matet kapaciteti organizativ i Shoqatës së Gjykatësve të Kosoves (SHGJK)

¹ David Sip, avokat, specializon në projekte që adresojnë qështje që kanë të bëjnë me demokraci dhe qeverisje. Sip ka një përvojë 20 vjeçare në zhvillim dhe menaxhim të demokracisë, shoqërisë civile, të drejta të njeriut dhe programe mbi sundimin e ligjit, dhe ka punuar në 15 vende. Ai ka ndihmuar në zhvillimin e një vlerësimi të vazhdueshëm të disa shoqatave, përfshirë tri organizata trashëgimtare të Rgjonit CEE.

Qëllimi është që të ipet një histori e memorizuar e SHGJK-së; për të dokumentuar progresin e shoqates deri më sot; identifikimi i anëve relative të forta dhe të dobëta dhe për të ofruar informacion me këndvështrim krahasues të nevojshëm për zhvillim të intervenimeve përforcuese. Gjithashtu ky vlerësim mund të përdoret për monitorimin dhe matjen e progresit përgjat kohës.

Metodologjia nuk ka përdorur shënim strikt numerik siç ishte përdorur në vitin 2005 në vlerësimin e RIBA-s. Është menduar se shqyrtimi i anëve të forta dhe të dobëta relative bazuar në situatën e tyre të tanishme do të ishte më e dobishme. Ky vlerësim ka konsideruar 10 komponente të efektivitetit organizativ; planifikimi strategjik dhe analiza: qeverisja; hartimi i projekteve dhe implementimi; menagjimi i sistemit dhe operatives; sigurimi i mjeteve financiare; mediat, marrëdhëniet publike, dhe marketingu; lobimi dhe avokimi, ndërtim dhe konstituimi, zhvillimi i anëtarisë, si dhe pjesmarrja e minoriteteve dhe barazia gjinore.

Metodologjia

Mjeti për Vlerësimin e Kapacitetit të OJQ-së (Pytësor dhe Shkallë)

Mjetet e Vlerësimit Organizativ të ABA-së (Procesi, Fletëpune, dhe Grafiku për matjen e Kapacitetit) që të dyjat pytësori dhe shkalla matëse, të përdorura për këtë vlerësim, u zhvilluan nga materiale të marrura nga IREX Program për OJQ-të Lokale në Kosovë, Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (ISC) Programi për Forcimin i Shoqërisë Civile në Maqedoni; Instituti Nacional Demokratik (NDI) mjete të kapacitetit organizativ; si dhe programi RIBA i ABA-së. Pyetjet ishin parashtrur ar gjatë intervistave të strukturuar me informator kyç dhe grupe të fokusimit, dhe përgjigjet regjistroheshin menjëherë për vlerësim..

Intervistat dhe Mbledhja e të Dhënave

Intervista me Informator Kyç dhe grupet e fokusimit udhëhiqeshin nga David Sip në mes të muajit 15 Mars – 25 Maj, 2007 dhe kanë zgjatur prej një deri në dy orë. Procesi ishte ndihmuar dhe ndjekur nga Drejtoresha Ekzekutive e SHGJK-së Lumnije Krasniqi dhe asistentja administrative Kadrije Brajshori, si dhe Arianit Osmani nga ABA. Një faqe me përmbledhje të vlerësimit, objektivat, dhe hpasirë për pyetje të mundshme ju ishte dhënë të gjith të intervistuarëve dhe ishte diskutuar me ta para fillimit të intervistave. (Shiqoni Faqen e bashkangjitur)

Intervistimi

Për shkak të numrit (316) të anëtarëve të SHGJK-së, ishte përcaktuar që intervistimi do të nxirrej nga anëtarët bazuar në: regjion; praktikë gjyqësore; niveli i përvojës së tyre si gjykatës (dhe si një anëtar i SHGJK-së); pozita në SHGJK; barazia gjinore dhe etniciteti. Katërdhjetë anëtarë u intervistuan, përfshirë këtu katër (4) gjykatës të përkatësisë Serbe, dhe dhjetë (10) femra, si dhe një numër i donatorëve ndërkombëtar dhe furnizues ndihmës.

Historia e Shoqates së Gjykatësve të Kosovës

Shoqata e Gjykatësve të Kosovës (SHGJK) është një shoqatë, vullnetare jo-qeveritare e gjykatësve aktiv të Kosovës e themeluar në Maj të vitit 2001. SHGJK-ja e ka Këshillin Drejtues prej 9 anëtarëve të përbërë nga gjykatës që përfaqësojnë të gjitha nivelet e gjyqësorit, dhe nga të gjitha regjionet e Kosovës. Një pozitë e Këshillit Drejtues të SHGJK-së është e rezervuar për një gjykatës nga komuniteti Serb dhe një tjetër pozitë për një gjykatës ndërkombëtar. SHGJK ka pesë degë, dhe secila degë ka delegatët e tyre të cilët votojnë për anëtarët e këshillit drejtues me mandate katër vjet. Secila degë mbajnë takimet e tyre dhe secila degë e ka kuvendin e saj dhe anëtarinë.

Komitetet të cilat ekzistojnë në SHGJK janë: komiteti për mbledhjen e fondeve; *praktikant*; resurse njerëzore; disiplinor; seminare dhe konferenca; komiteti për çështje administrative; e drejtë penale; e drejtë civile. Këto dy të fundit janë për ekspertët të cilët mund të hartojnë ligje dhe ose të komentojnë ligje. Gjithashtu është edhe këshilli redaktues që publikon Buletinin. Shumica e këtyre komiteteve takohen vetëm në raste ad hoc pra kur është e domosdoshme.

Misioni i SHGJK-së është i fokusuar “në mbrojtje dhe ngritje të interesave të gjykatësve si dhe avancimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet ndërtimit të një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm të bazuar në sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut” . SHGJK-ja është e fokusuar në arsimim gjyqësor dhe zhvillim profesional të anëtarëve të saj. Për një qëllim të tillë përfaqësues të shoqates kanë marrë pjesë në Konferencën Regjionale të Kosovës, gjithashtu në konferencën Shoqatat Gjyqësore për Planifikim Strategjik të Maqedonisë dhe Malit të Zi, financuar nga Shoqata e Avokatëve Amerikan/Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ABA-ish ABA/CEELI), pra në Shkup, Maqedoni në Mars të vitit 2002. Si rezultat i kësaj konference organizata është përfshirë më fort në procesin e hartimit të planit të tyre të parë strategjik dhe në implementimin e aktiviteteve të tyre në praktikë më me efikasitet. Për më shumë SHGJK-ja në bashkëpunim me ABA-në dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) ka finansuar diskutime- tryeza të rrumbullakëta të një pas njëshme me gjykatës Kosovar që kishin marrë pjesë në vizita studimore në vende të ndryshme të Evropës dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. SHGJK-ja gjithashtu ka ndjekur aktivitete të avokimit në lidhje me emërimet gjyqësore nga organizatat ndërkombëtare (UNMIK); përmirsim të kushteve të personelit gjyqësor dhe siguria e gjykatësve, këtë e ka bërë nëpërmjet komunikatave për media që u publikuan në gazetatat kryesore ditore të Kosovës, siç janë Koha Ditore dhe Bota Sot kjo pra në fillim të vitit 2003.

SHGJK-ja punësoi anëtarin e parë të personelit, një administratore – Zonjusha. Kadrije Brajshori në vitin 2003, dhe komplettoi një ABA/RIBA vlerësim në vitin 2005.

SHGJK-ja ka mbledhur një numër modest të buletineve dhe gazetave për një bibliotekë profesionale për gjykatës në Kosovë; ka zbatuar një Program Gjyqësorë për *Praktikant* të përkrahur nga ABA dhe USAID; dhe me ndihmë profesionale dhe financiare të ABA-së dhe USAID-së, Komitetit Finlandez për të Drejtat e Njeriut, Komitetit të Kryqit të Kuq dhe KFOS-i (SOROS), çdo tre muaj publikon Buletinin për të gjithë anëtarët dhe partnerët e SHGJK-së .

SHGJK-ja bashkëpunon ngusht dhe në mënyrë profesionale është e aktivizuar me Oden e Avokatëve të Kosovës. Pas ndjekjes së një iniciative të ABA-së dhe Z. Michael Greco, ish President i ABA-së, në vitin 2005, SHGJK-ja me sUSKes zbatoi një projekt të tryezave të rrumbullakëta me Avokatë dhe Gjykatës pra në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës. Si rezultat kishte diskutime nga këto tryeza të rrumbullakëta në lidhje me qështjet që shqetësojnë të dyja palët gjykatësit dhe avokatët në të gjitha pra pesë regjionet e Kosovës.

Në fund të vitit 2006 SHGJK-ja me ndihmën e ABA-së, rekrutuan dhe punësuan Znj. e parë Lumnije Krasniqi drejtoreshë ekzekutive. Trajnimi i Avokimit dhe Qendra për Resurse (ATRC) organizoi një seminar për SHGJK-në mbi planifikimin strategjik, që rezultoi në hartimin e planit strategjik 3 vjeçar që është duke u rishikuar nga anëtarët e SHGJK-së. SHGJK-ja gjithashtu ka zhvilluar një draft plan për zhvillim të avokimit. Nën udhëheqësinë e drejtoreshës së tyre të re të emëruar, SHGJK-ja zhvilloi dhe dorëzoi propozim projekte Fondacionit për Shoqëri të Hapur dhe Qendrës Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC) që të dyja këto projekte më pas u aprovuan.

Për më tepër në vitin 2007 SHGJK-ja në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe sponsoruar nga Qendra Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC), ishte përfshirë në projektin për avokim dhe anti-korrupsion. Si pjesë e këtij projekti, SHGJK-ja në bashkëpunim me partnerë tjerë ka mbajtur disa tryeza të rrumbullakëta në qendra të ndryshme të Kosovës, me pjesëmarrës gjykatës, avokat dhe prokurorë. Çka është me rëndësi këto tryeza kishin tërheqës vëmendjen e mediave në të dy anët pra duke u transmetuar në lajme dhe programe të drejtpërdrejta, ku përfaqësuesit e organizatave sponsoruese kanë diskutuar çështje që kanë të bëjnë me korrupsionin. Projekti është duke vazhduar.

SHGJK-ja punon ngusht me organizatat lokale dhe ndërkombëtare që kontribuojnë duke mbështetur sistemin gjyqësor dhe rolin e tij në shoqëri. Shumica e organizatave të rëndësishme që SHGJK-ja ka bashkëpunuar me to në projekte të ndryshme janë: Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Komiteti Finlandez për të Drejta të Njeriut, Fondacioni për Shoqëri të hapur, Qendra Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC), si dhe me ABA-në – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ka një bashkëpunim të mirë në mes të SHGJK-së dhe ABA-së, dhe Qendres Nacionale për Gjykata Shtetërore NCSC dhe IGJK.

Konkludime & Sugjerime/10 Komponentet e Shqyrtuara

Plani Strategjik: SHGJK-ja ka aktivizuar Qendren Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC), një OJQ lokale, për të udhëhequr një seminar tre ditor mbi planifikimin strategjik në Ohër të Maqedonisë. Qëllimi ishte për të zhvilluar një plan të ri strategjik tre-vjeçar dhe kështu bë hartimi i parë i planit strategjik 2002-2005. Seminari u mbajt në Nëntor prej 14-17, dhe aty moren pjesë 17 gjykatës nga pesë regjionet – qarqet si dhe dy administratorët nga personeli i SHGJK-së. Gjithashtu në seminar mori pjesë edhe një anëtarë nga komuniteti Serb. Në fund të Seminarit pjesëmarrësit hartuan draftin e parë të Planit Strategjik të SHGJK-së për vitin 2007-2009.

Drafti përfshinë ndryshimin e deklaratës së misionit, përshkrimi i pozitave të punës së drejtoreshës ekzekutive dhe administratores; dhe shprehë përkushtimin e SHGJK-së për avokim dhe lobim dhe aktivitetet kundër korrupsionit. Seminari ishte moderuar nga dy trajnues të ATRC-së. Palët u pajtuan që shqyrtimi dhe zbatimi i planit strategjik do të mbikqyrej në bashkëpunim me stafin e SHGJK-së, trajnuesit e ATRC-së dhe ABA.

SHGJK-ja vazhdon filtrimin e draftit të planit strategjik 2007-2009 për ta përgatitur atë për shqyrtim dhe diskutim me anëtarësinë – që pastaj pritet që drafti do të aprovohet. Udhëheqësit e SHGJK-së përfshirë Kryetarin Huruglica dhe Lumnije Krasniqi Drejtoresha Ekzekutive, si dhe stafi i ABA-së, kishin mbajtur një takim shqyrtues në Shkurt të vitit 2006 me përfaqësues të ATRC-së për të përmirësuar draftin. Në takim u detajizuan seksione të planit strategjik që kanë të bëjnë me aktivitetet praktike të SHGJK-së. Më konkretisht, secili aktivitet ishte detajizuar duke sqaruar personat/mekanizmat të cilët udhëheqin këto aktivitete, afatet kohore dhe buxhetet e pakonsoliduara. ABA vazhdon të jap sugjerime për përmirësimin e draft planit, dhe është në diskutime me SHGJK-në në lidhje me kompletimin dhe shqyrtimin e draftit.

Sugjerime:

- SHGJK – ja duhet ta përfundojë draftin e planit strategjik dhe t'ja dorëzojë anëtarëve për shqyrtim duke mos lënë që kjo të zgjasë shumë. Drafti i parë i planit ishte kompletuar në Janar, dhe tani është afër muaji Qershor ata janë duke lejuar që shumë kohë të kalojë pa parë ndonjë progres.
- SHGJK-ja duhet të sigurojë që plani strategjik të përfshijë: avokim dhe lobim në emër të anëtarëve të tyre – ky është një prioritet shumë i qartë për anëtarët. Drafti gjithashtu duhet të përfshijë; luftimin e korrupsionit brenda profesionit: të bëjë prioritet rekrutimin dhe mbajtjen e femrave dhe minoriteteve në profesion dhe të gjejë rrugë për përmirësimin e projektit të *Praktikantëve*.
- SHGJK-ja duhet të përdor planin strategjik për të mobilizuar dhe re-energizoj anëtarësinë duke ja dhënë planin strategjik anëtarëve për shqyrtim në mënyrë që anëtarët të dinë se çfarë është duke bërë SHGJK-ja dhe, kjo pra të bëhet në mënyrë që anëtarët të jenë të informuar mirë. Kjo do të shërbejë për të informuar anëtarët për prioritetet e SHGJK-së.
- SHGJK-ja duhet të vazhdojë një dialog me Institutin Gjyqësor për të diskutuar për nevojat e trajnimit dhe të koordinojë aktivitetet.
- SHGJK-ja dhe Gjykatësit Ndërkombëtar duhet të vazhdojnë të eksplorojnë mundësi për Gjykatësit Ndërkombëtar dhe ata lokal që të takohen dhe të këshillohen nga njëri tjetri.

Qeverisja: SHGJK-ja e ka Këshillin Drejtues prej 9 anëtarëve të përbërë nga gjykatës që përfaqësojnë të gjitha nivelet e gjyqësorit, dhe nga të gjitha regjionet e Kosovës. Një pozitë e Këshillit Drejtues të SHGJK-së është e rezervuar për një gjykatës nga komuniteti Serb dhe një tjetër pozitë për një gjykatës ndërkombëtar. SHGJK ka pesë degë, dhe secila degë ka delegatët e tyre të cilët votojnë për anëtarët e këshillit drejtues me mandate katër vjet. Secila degë kanë takimet e tyre dhe secila degë ka kuvendin dhe anëtarësinë. Edhe pse secila degë mbajnë takimet e tyre rregullisht anëtarët tjerë nuk dinë se çfarë ndodhë gjatë këtyre takimeve. Zakonisht në takime marrin pjesë Kryetari i degës dhe vetëm anëtarët e bordit, dhe jo anëtarët tjerë

Komitetet të cilat ekzistojnë në SHGJK janë: komiteti për mbledhjen e fondeve; praktikant; resurse njerëzore; disiplinor; seminare dhe konferenca; komiteti për çështje administrative; e drejtë penale; e drejtë civile. Këto dy të fundit janë për ekspertët të cilët

mund të hartojnë ligje dhe ose të komentojnë ligje. Gjithashtu është edhe këshilli redaktues që publikon Buletinin. Shumica e këtyre komiteteve takohen vetëm në raste ad hoc pra kur është e domosdoshme.

Sugjerime: Në tërësi, qeverisja e SHGJK-së është duke funksionuar mirë. Ekzistojnë statute dhe ato respektohen: udhëheqësit janë të ndarë dhe duket se funksionon në mënyrë demokratike, bordi dhe stafi i kanë rolet e ndara (edhe pse këto role mund të mos jenë të qarta për të gjithë); komitetet janë në vende të duhura; dhe takimet zhvillohen rregullisht. Sugjerohet që këshillit dhe stafit t'ju **definohen qartësohen pozitat në mënyrë që rolet e tyre të definohen dhe dallohen**, p.sh cili është roli dhe çka pritet nga anëtarët e këshillit drejtues; cili është roli dhe çka pritet nga kryetarët e degëve regionale; cili është roli i stafit në relacion me anëtarët e këshillit? Kryetarëve të komiteteve dhe anëtarëve gjithashtu duhet t'ju definohen pozitat; në mënyrë që të definohen rolet e komiteteve të veçanta dhe çka do të pritet nga ata. **Rolet përgjegjësitë, dhe gjërat që pritet të ndodhin duhet t'ju komunikohen të gjithë anëtarëve.** Gjithashtu sugjerohet që SHGJK-ja të plotësoj pozitën e hapur për gjykatësin ndërkombëtar që të jetë në këshillin e tyre drejtues.

Hartimi i Projektit dhe Implementimi:

- **Publikimi i Buletinit:** SHGJK-ja ka ndërmarr disa hapa premtues për të ndërtuar aftësinë e saj të komunikimit. Nëpërmjet Këshillit Redaktues, SHGJK-ja ka publikuar disa çështje nga buletini dhe në këtë mënyrë ka ngritur përmbajtjen e buletinit, kështu vazhdimisht e ka ngritur profilin SHGJK-së si një institucion dhe ka shpërndarë informacion mbi zhvillimet ligjore. SHGJK-ja ka shfrytëzuar në maksimum trajnimin për publikime ofruar nga World Learning. Këshilli Redaktues gjithashtu ka qenë në kërkim të individëve të cilët mund të kontribuojnë në plotësimin e artikujve në Buletin dhe ka futur publikim të rregullt të artikujve mbi etikën. Shpesh Buletini citohet si një ndër projektet më të mira të SHGJK-së, dhe në të shumtën e rasteve kjo është e vetmja mënyrë kur anëtarët marrin informata nga SHGJK-ja.

Me qëllim të ngritjes së kapacitetit botues të SHGJK-së, Këshilli Redaktues i SHGJK-së, në bashkëpunim me ABA-në, kishte sponsoruar një seminar gjysmë-ditor për publikim të Buletineve. Seminari përfshinte prezantime për çështje gazetareske dhe publikime nga Z. Dan Webster profesor i gazetarisë në Universitetin Gonzaga në Washington, SHBA. Gjatë prezantimit gjysmë-ditor mbajtur me 10 të Nëntor. Z. Webster kishte ndarë nga përvoja e tij dhe disa nga sfidat kryesore që gazetarët dhe botuesit i hasin gjatë procesit të botimit.

Sugjerime:

- **Përmbajtje** – konsideroni të përfshini në Buletin artikuj që japin të dhëna të fundit mbi projektet e SHGJK-së etj. Pasi që Buletini shpesh është e vetmja mënyrë e komunikimit të SHGJK-së me anëtarësinë atëherë sugjerohet që Buletini të përfshijë më shumë informacione për SHGJK-në
- **Shpërndarja** – konsideroni shpërndarje më të gjerë të Buletinit, pra avokatëve, Ministrisë së Drejtësisë, Medieve, etj. Buletini mund të përdoret për të promovuar SHGJK-në në audienca dhe media të ndryshme

- Përdorimi i medieve – konsideroni të punoni me media për të zgjeruar shtrirjen Buletinit dhe të vetë SHGJK-së dhe mesazheve të SHGJK-së:
- **Shpeshësi** – konsideroni botimin e Buletinit më shpesh. Përsëri, anëtarët në mënyrë të vazhdueshme kanë theksuar se Buletini është një ndër projektet më të mira të SHGJK-së, dhe nëse do ta publikonin më shpesh do të mund të ndihmonte në promovim të vet SHGJK-së dhe vetëdijesim të anëtarësisë.
- **Avokim dhe Lobim:** Në Dhjetor të vitit 2006 në Shkup të Maqedonisë, SHGJK-ja në bashkëpunim me ABA-në organizoi trajnim dy ditor dhe një trajnim tjetër gjysmë – ditor mbi Avokimin dhe Ndërtim të Koalicionit. Gjithashtu seminari ishte moderuar nga ATRC-ja, dhe ishte ndjekur nga 15 gjykatës dhe stafi i SHGJK-së. Në seminar pjesëmarrësit vendosën që të fokusohen në aktivitetet e ardhshme të avokimit dhe lobimit për statusin dhe të drejtat e punës së gjykatësve, dhe ata identifikuan një numër të madh të çështjeve prioritare që i shqetësojnë gjykatësit përfshirë inspektionin dhe emërimin e gjykatësve të rinj, pozita sociale dhe të drejtat e punës së gjykatësve. Implementimi i aktiviteteve të SHGJK-së mbi avokimin do të monitorohen nga stafi i SHGJK-së, trajnuesit e ATRC-së, dhe ABA.
- Përmbledhje nga seminarët Gjykatës/Avokat: Në fund të vitit 2005, ish Kryetari i ABA-së Z. Michael Greco, në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe me Shoqatën e Gjykatësve të Kosovës u pajtuan se ishte me rëndësi për shoqatat që të zhvillojnë aktivitete të përbashkëta për çështjet me interes të përbashkët. Ishte diskutuar për Idenë e krijimit të takimit formal Gjykatës/Avokat, dhe Tryeza e parë e Diskutimit Gjykatës/Avokat u mbajt në Prishtinë në Dhjetor, 2005, kryesuar nga Michael Greco. Prej atëherë, u mbajtën edhe katër Tryeza të Diskutimeve Gjykatës/Avokat në secilin regjion duke mbuluar tema të ndryshme të identifikuar nga grupi i përbashkët punues Gjykatës/Avokat. Çdo tryezë fokusohet në dy tema të gjëra kryesore dhe konkludime dhe rekomandime nxirreshin nga çdo sesion. Në Qershor të vitit 2007, grupi punues Gjykatës/Avokat i Kosovës organizoi konferencën e gjashtë dhe të fundit në Prishtinë, dhe solli personalitete kyçe të sistemit gjyqësor për të dëgjuar rezultatet e dalura nga 5 tryezat e më hershme dhe Agjendën e përbashkët të avokimit e nxjerrur nga tryezat, dhe rolet e shoqatave në reformimin e sistemit ligjor në Kosovë.

Përmbledhja e agjendës mbi Avokimin: Njëra prej rezultateve të dala nga Diskutimet tryezave Gjykatës/Avokat ishte rafinimi i agjendave të avokimit nga dy shoqatat. OAK-ja dhe SHGJK-ja konsideruan përfshirjen e disa burimeve në aksion - agjendat e tyre prioritare që ishin iniciuar në seminarin e tyre të mbajtur me ATRC-në në Dhjetor të vitit 2006: Diskutimet nga tryezat Gjykatës/Avokat; faktorët nga IRGJ –ja dhe IRPL-ja; dhe anketimi jo zyrtar i anëtarësive të tyre përkatëse. Që të dy shoqatat kanë filluar të flasin, të japin deklarata dhe paraqitje në televizion në emër të anëtarësive të tyre për këto çështje të rëndësishme.

Sugjerime: Shikoni më Poshtë nën Avokim dhe Lobim.

- **Praktikant:** Projekti për *Praktikant* është një projekt për ndërtim profesional dhe projekt zhvillimor i kombinuar me trajnime formale dhe seminare i shoqëruar me praktikë me avokatë ose gjykatës. Kompletimi i Praktikës një-vjeçare është e obligueshme për të diplomuarit e fakultetit juridik para se ata të mund ti nënshtrohen provimit të jurisprudencës. Që nga viti 2002 kur filloi projekti për *Praktikant* më OAK-në, 104 të diplomuar nga Fakulteti Juridik kompletuan kursin. Me ndihmën e ABA-së, OAK-ja kishte nxjerrur 74 Praktikant (20 në 2002; 20 në 2003; 20 në 2004; 10 në 2005; dhe 4 në 2006). Me ndihmën e ABA-së, SHGJK-ja kishte nxjerrur 20 *Praktikant* (5 në 2003; 5 në 2004; 20 në 2006) Në vitin 2005 OAK-ja e adoptoi këtë aktivitet si të vetin dhe vazhdon ta financoj këtë projekt duke përdorur burimet e tyre financiare vetanake.

Në vitin 1 të planit të punës së tanishme të ABA-së, ABA u përkushtua në mbështetjen e 5 Praktikantëve për projektin e SHGJK-së. Ky numër më pastaj u rrit deri në 20. Për këtë arsye, ABA shpenzoi dy herë më shumë sesa që kishte parashikuar në shpenzimin e këtij projekti gjatë vazhdimin të dy viteve të marrëveshjes së bashkëpunimit. Një vendim praktik u arrit që të mos përkrahet asnjë Praktikant për vitin e 2 të sepse do ta pakësonte financimin dhe kështu kërcënonte kompletimin e objektivave të planit të punës së ABA-së.

ABA dëshiron të inkurajoj vazhdimin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e këtij projekti dhe ta bëjë Projektin për *Praktikant* prioritet për SHGJK-në dhe OAK-në duke ndihmuar shoqatat për të zhvilluar qasje të përbashkët dhe për të kërkuar mënyra të mundshme për siguruar ndihmë financiare.

Sugjerime:

- **Të vazhdohet me projektin për *Praktikant* pra të bëhet prioritet dhe të fillohen diskutime për këtë** me OAK-në dhe KGJK, Ministrinë e Drejtësisë dhe ABA në zhvillimin e një qasje të përbashkët për projektin për Praktikant.

Planifikimi Financiar dhe Menaxhimi: SHGJK-ja ju nënshtroja një auditivi këtë vit, dhe ishte e kënaqur me rezultatet. Ata konkluduan se fondet po përdoren sipas marrëveshjes, dhe në mënyrë të duhur. Financat ishin në rregull, gjithashtu librat, duke përfshirë raportet financiare, buxhetet, raportimi i taksave, si dhe dokumentet tjera financiare rregullisht arkivohen dhe fajlohen ashtu siç duhet.

Sugjerime:

- Të vazhdohet me auditime të brendshme periodike.

Menaxhimi i Resurseve Njerëzore: Stafi i SHGJK-së marinë beneficione sociale, dhe ata e përmendin këtë si një stimulim i të qenurit të punësuar nga SHGJK-ja. Anëtarët e SHGJK-së kanë mundësi të ndryshme trajnime, seminare, udhëtime, por ndoshta ata duhet ta rishikojnë procesin e selektimit se si anëtarët selektohen për të marrë pjesë në seminare apo trajnime. Anëtarët e stafit nuk kanë të njëjtat mundësi të zhvillimit

profesional ashtu si anëtarët e këshillit. Punësimi i drejtoreshës së parë ekzekutive ka rezultuar në përmirësime në menaxhimin e SHGJK-së.

Sugjerime: **Stafi duhet të inkurajohet të marrë pjesë në trajnimet dhe seminarat e tyre që do të rezultonte në zhvillimin edhe të tyre profesional,** sepse kjo ka të bëjë me rolet e tyre në shoqatë. Menaxhimi i kohës, hartimi i projekteve, implementimi, dhe buxheti janë disa nga seminarat që stafi do të përfitonte, por gjithashtu zhvillimi i anëtarësisë dhe shtrirje sa më të gjerë. SHGJK-ja do të përfitonte nëse stafi i tyre do të fliste, lexonte dhe nëse do të shkruante Serbisht.

SHGJK-së i duhet të rishikoj procesin e selektimit të anëtarëve për të marrë pjesë në seminare, trajnime apo evenimente të ndryshme. Shumë anëtarë mendojnë se procesi i selektimit nuk është i drejtë dhe vetëm disa persona të njëjtë apo të caktuar selektohen vazhdimisht dhe në mënyrë të përsëritur për të përfituar nga këto seminare, trajnime etj. SHGJK-ja duhet ta **shqyrtoj dhe mundësisht ta rishikoj procesin e tyre, dhe pastaj në mënyrë ta qartë t'ia komunikoj anëtarëve të tyre.** Është e mundshme që anëtarët nuk e kuptojnë apo nuk njohin mirë këtë proces, dhe përsëri kjo varet nga SHGJK-ja që t'ua komunikoj këtë në mënyrë të qartë atyre. Për momentin, stafi pra SHGJK-ja e kanë të ndarë një zyrë në ndërtesën e ABA-së. Stafi i ABA-së duhet të këshillohet që të kalojë kohë me SHGJK-në për të shkëmbyer përvoja dhe aftësim. Kur SHGJK-ja do ta ketë zyrën e saj pra të ndarë nga ABA, atëherë përsëri ABA duhet të konsideroj t'i siguroj SHGJK-së ndihmë të vazhdueshme për të ngritur aftësimin e SHGJK-së

Menagjimi Funkcionues dhe Sistemor: Komunikimi i brendshëm duket të jetë pikë e dobët e zhvillimit të SHGJK-së. Anëtarët tjerë e dinë se kush është kryetar i Shoqatës, por shumica nuk kanë mundur të identifikojnë në mënyrë të qartë emrat e anëtarëve tjerë ekzekutiv të këshillit. Shumica e anëtarëve i njohin drejtorët e tyre regional, dhe e dijnë se ata takohen rregullisht, por nuk kanë mundur të tregojnë se çfarë ndodh në këto takime. Anëtarët tjerë pra të rregullt nuk marrin ndonjë informacion nga zyra qendrore apo nga udhëheqësit e SHGJK-së përveç Buletinit, dhe shumica nuk kanë qenë të sigurtë se çfarë është duke bërë SHGJK-ja. Shumica e anëtarëve thonë se ata marrin pjesë një apo dy herë në vit, pra më së shumti në nivel regional. Komunikimi i jashtëm është diçka më e mirë, dhe SHGJK-ja është e gatshme dhe të shkëmbejë informata dhe të diskutojë çështje me organizata të tjera.

Për momentin pajisjet që përdoren bashkërisht, përdoren mirë nga SHGJK-ja, dhe SHGJK-ja e shfrytëzon hapësirën pa pagesë nga ABA, qysh prej fillimit të tyre. Kjo do të ndryshoj këtë vit, megjithatë, kur SHGJK-ja të gjej zyrë në ndonjë vend tjetër. Kjo do të shkaktoj pak stres për stafin e SHGJK-së, sepse ata vazhdimisht kanë nevojë për ndihmë nga stafi i ABA-së (shikoni komentet më lartë) Kjo gjithashtu mund ta dëmtoj financiarisht SHGJK-në.

Stafi i SHGJK-së sigurisht do të duhej ta menaxhonte kohën e tyre më mirë. Stafi ka theksuar se situata e tyre do të përmirësohej dukshëm, dhe SHGJK-ja do të funksiononte më mirë, nëse do të shtoheshin edhe pesë anëtarë stafit të SHGJK-së. Kjo zakonisht tregon se menaxhimi i kohës nuk është në nivel të duhur sesa nevojat për staf shtesë.

Sugjerime: Në mënyrë që komunikimi i brendshëm të përmirësohet, sugjerohet që **kryetarët e degëve të ftohen në takimet e këshillit drejtues.** Në këtë mënyrë, kryetarët e degëve do të ishin më mirë, dhe me kohë të pajisur dhe të kompletuar me

informacione të marrura drejtpërsëdrejti nga këshilli drejtues dhe do të jenë në gjendje që këtë informacion t'ua transmetojnë bordeve të tyre regjionale. **Bordet regjionale duhet të takohen rregullisht** për të diskutuar agjendat e tyre por gjithashtu edhe për të ndarë mesazhet e këshillit drejtues njëri tjetrit dhe duhet të ftojnë **anëtarët tjerë** për të marrë pjesë dhe për të observuar. Kjo do të ndihmonte në përmirësimin e komunikimit në anëtarësi.

Mbledhja e Mjeteve Financiare:

Pagesa e Anëtarësisë: Udhëheqësia e re e Degës së Prishtinës e SHGJK-së ka filluar mbledhjen pagesave të anëtarësisë më një vullnet mbresëlënës. Znj. Biljana Rexhiq, kryetarja e posa zgjedhur për degën e Prishtinës e shoqëruar nga Administratorja e SHGJK-se, gjatë gjysmës së dytë të Shtatorit 2006 ka vizituar shumicën e Gjykatësve regjional të Prishtinës. Gjatë këtyre intervistave Znj. Rexhiq theksoi rëndësinë e pagesës së anëtarësisë dhe përfshirjen aktive në aktivitete tjera të SHGJK-së. Udhëheqësja e SHGJK-së si dhe stafi i ABA-së besojnë se nëse Znj. Rexhiq vazhdon me këtë entuziazëm dhe energji duke motivuar Degën e Prishtinës, do të ketë një valë të efektit pozitiv në funksionimin e SHGJK-së. Ajo do të mund të ishte model për Udhëheqësit tjerë të Degëve si dhe në mbledhjen e të hollave nga anëtarësia.

Propozim Zhvillimi: Me ndihmën teknike të siguruar nga stafi i ABA-së, SHGJK-ja ka hartuar një projekt propozim mbi instrumentet dhe normat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe aplikimi i tyre në legjislacionin e Kosovës. Projekt propozimi me vlerë 6, 980 Euro i ishte dhënë Fondacionit për Shoqëri të Hapur dhe ishte aprovuar. Nëpërmjet këtij projekti SHGJK-ja do të zhvilloj seminare për të gjithë Gjykatësit e Kosovës, për të ekzaminuar çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe aplikimi i tyre në gjykatat e Kosovës.

Propozimi i SHGJK-së mbi Transparenca dhe Anti-Korrupsioni në Sistemin Gjyqësor në Kosovë ishte aprovuar nga ATRC-ja dhe USAID, dhe projekti me vlerë 25,000 \$ Amerikan filloi. Pritet që implementimi i këtij projekti të kontribuojë dukshëm në zhvillimin e më tutjeshëm të kapacitetit organizativ të SHGJK-së. Gjithashtu mund të ngritët profili i kësaj organizate tek publiku i Kosovës dhe tek aksionaret tjerë të SHGJK-së. Aktivitetet e planifikuara të implementohen brenda këtij projekti do të kontribuonin më shumë në luftimin më efikas të korrupsionit në gjyqësor, që si rezultat do të rriste kredibilitetin e gjyqësorit të Kosovës para publikut.

Takimet me Donatorë: Në një zhvillim të ndarë përfaqësues të SHGJK-së, me ndihmën e ABA-së kishin caktuar takim me UNDP-në për të financuar aktivitetet e SHGJK-së. Qëllimi ishte të diskutoheshin mundësi nga ana e UNDP-së të financohen aktivitetet të SHGJK-së. Sipas Lumnije Krasniqi, Drejtoreshë Ekzekutive e SHGJK-së, me sa duket UNDP-ja kishte premtuar që do vazhdonte komunikimin me SHGJK-në dhe ndërkohë të filloj kërkimin e mundësive të reja për të financuar aktivitetet e SHGJK-së. SHGJK-ja gjithashtu kishte zhvilluar dhe dorëzuar një propozim Fondacionit Anglez Westminister, por propozimi ishte refuzuar.

Sugjerime:

- SHGJK-ja duhet ta **bëjë prioritet zhvillimin e një strategjie për sigurimin e fondeve** që do të konfirmonte se SHGJK-ja ka kapacitet të limituar për të gjeneruar fonde apo të ardhura dhe të bëhet financiarisht e pavarur. Kjo strategji duhet të llogaris faktin që gjykatësit dhe SHGJK-ja janë të obliguar të respektojnë etikën pra janë të ndaluar të sigurojnë apo mbledhin fonde në mënyra tradicionale apo duke organizuar ndoshta evenimente që kanë të bëjnë pikërisht me mbledhjen apo sigurimin e të hollave si dhe shitjen e publikimeve. Në raste të tilla ata mund të japin një pamje jo të mirë edhe pse ndoshta këto mund të mos jenë në të vërtetë mito. Rrjedhimisht SHGJK-ja ka vetëm tri burime potenciale të mundshme të financimit: pagesat nga anëtarësia, nga qeveria si dhe donatorët ndërkombëtar. Gjykatësit konsiderojnë se pagat e tyre janë të vogla dhe të pamjaftueshme madje disa gjykatës nuk paguajnë anëtarësinë e vogël që tani paguhet. Përdorni shembullin e Degës së Prishtinës të mbledhjes së anëtarësisë; konsideroni kompanitë private;
- Pagesa e anëtarësisë është 30 euro në vit, gjithsejtë janë 313 gjykatës anëtarë të shoqatës. Totali që do të duhej apo do të mund ta mblidhnin është 9000 Euro në vit. Ndërsa totali që ata tani janë duke e mbledhur është nga 2000 deri në 3000 Euro në vit. SHGJK-ja duhet të jetë më agresive në mbledhjen e fondeve – duke e bërë këtë ata do të mund të paguanin qiranë vjetore si dhe shpenzime tjera. Shumë anëtar kanë shprehur vullnetin që të paguajnë, më shumë se sa që tani është duke u pagjuajtur nëse SHGJK-ja do të punonte me të vërtetë për ata dhe nëse këtë do të mund ta demonstronte.

Mediat, Marrëdhëniet Publike dhe Marketingu: Vetëm disa nga pjesa dërmuese e anëtarëve e dinin se SHGJK-ja ka çështje prioritare, ose që SHGJK-ja kishte dhënë një deklaratë të shkruar në media dhe që ishte shfaqur në televizion për një bisedë për të diskutuar për këto çështje. Kjo kishte ndodhur në Mars, por shumë pak është bërë prej atëherë, dhe shumica e anëtarëve nuk kanë ide se kjo ka ndodhë. Ky pikërisht është një lloj aktiviteti që do të rriste përkrahjen e anëtarëve për SHGJK-në nëse anëtarët do të ishin të informuar. Dhe pikërisht ky është aktiviteti që shumica e anëtarëve dëshirojnë ta shohin SHGJK-në duke u zhvilluar. Lobim për përmirësimin e kushteve në emër të tyre dhe duke i siguruar që anëtarësia të jetë e vetëdijshme se do kalojë nëpër rrugë të gjatë në përmirësimin e marrëdhënieve me anëtarët dhe rritjen e besimit të tyre në SHGJK –në.

Sugjerime:

- ABA do ta inkurajoj udhëheqësinë e SHGJK-së për ta caktuar **një zëdhënës** të shoqatës në ndërtimin dhe aftësimin a vazhdueshëm në marrëdhënie me media dhe komunikim më publikun.
- Puna e SHGJK-së me **media** duhet të jetë e lidhur drejtpërsëdrejti **me punën e tyre të avokimit** – deklarata e fundit për media si dhe paraqitja në televizion është një shembull i mirë por kjo duhet të jetë një angazhim i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm përgjatë tërë vitit e jo vetëm një aktivitet i tillë gjatë tërë vitit

SHGJK-ja duhet të përcjell artikujt dhe raportet e medieve në lidhje me gjykatësit dhe gjyqësorin, dhe ndoshta të jetë e përgatitur të përgjigjet nëse është e nevojshme.

Avokimi dhe Lobimi; Ndërtim të Konstitucionalizmit; dhe Zhvillim të Anëtarësisë: Gjithashtu shikoni më lart në seksionin Hartimi i Projekteve dhe Implementimi.

Sugjerime:

- SHGJK-ja dhe Komiteti Legjislativ i SHGJK-së duhet të marë rolin e udhëheqësisë në shqyrtimin e draft ligjeve të tanishme si dhe të japin komente për ligjet e propozuara që do të mund të ndikojnë në gjyqësor. Kjo duhet të inkorporohet në Agjendën e tyre për Avokim.
- SHGJK-ja duhet të zhvilloj lobim për çështje siç janë rritja e pagave mujore për gjykatësit, staf të përshtatshëm, përkrahje teknologjike si dhe përkrahje administrative dhe operative.
- SHGJK-ja ka shtuar bashkëpunimin e saj me KGJK-në që është parë si një lëvizje pozitive. SHGJK-ja duhet të konsideroj bashkëpunim të shtuar me OAK-në dhe Shoqatën e Prokurorëve të Kosovës.
- SHGJK-ja mund të mësoj më shumë duke qenë e përfshirë me shoqatat tjera ndërkombëtare duke përfshirë shoqatat e gjykatësve nga vendet tjera – si është raporti me Shoqatën e Gjykatësve të Serbisë?

Barazia Gjinore dhe Pjesëmarrja e Minoriteteve: në të gjitha intervistat e mbajtura është theksuar nga anëtarët se SHGJK-ja ofron mundësi të barabarta për pjesëmarrjen dhe avancimin e femrave dhe minoriteteve, dhe si shembull të për këtë kanë cituar pjesëmarrjen në seminare. Disa anëtarë thanë se SHGJK-ja ka humbur disa nga anëtarët Serb, dhe SHGJK-ja duhet të sjellë këta ish anëtarë për ti bindur për përfitimet e të qenurit anëtarë.

Sugjerime: SHGJK-ja duhet ta bëjë prioritet këtë aktivitet dhe ta përfshijë në planin e tyre strategjik. SHGJK-ja duhet të punoj ngushtë me komitetin për barazi gjinore për të zhvilluar aktivitete së bashku. Ashtu siç ishte përmendur më lartë, SHGJK-ja do të përfitonte nga stafi nëse stafi do të dinte gjuhën serbe shkrim lexim. Gjithashtu SHGJK-ja duhet të siguroj përkthim të mirë për anëtarët etnik serb – kjo përfshinë të gjitha pra dokumentet e shkruara si dhe përkthimi. Përdërisa kjo nuk ndodhë SHGJK-ja nuk mund të presë pjesëmarrje serioze nga ana e serbëve etnik.

Konkludim

SHGJK-ja ka filluar të vërejë potencialin e sajë vitin e fundit, por kjo kërkon ndihmë të vazhdueshme në ndërtimin e kapacitetit. Deri në vitin 2006, ABA kishte punuar në ngritjen e kapacitetit themelor të SHGJK-së nëpërmjet programit RIBA. ABA ka ndërruar fokusin e punës për ta ndihmuar SHGJK-në në mbledhjen e resurseve dhe është duke bërë një angazhim më të koncentruar për ta ndërtuar rolin e saj si një zë udhëheqës për gjykatësit e Kosovës, për të punuar në ndërtimin e një sistemi të pavarur dhe të paanshëm gjyqësor dhe për të sjellë besimin e publikut në gjyqësor.

SHGJK-ja ka bërë progres dhe tani është në pozitë që në mënyrë energjike të ngritët për kauzën e një sistemi të drejtësisë dhe gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe transparent të bazuar në sundimin e ligjit. ABA-ja do të inkurajoj SHGJK-në për të bashkuar forcat me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK-në),

dhe ndoshta me shoqatën e Prokurorëve, për të promovuar dhe mbrojtur një sistem ligjor të fortë, të paanshëm, efektiv të pavarur të drejtësisë në Kosovë, dhe për tu fokusuar dhe intensifikuar angazhimet e tyre për tu bërë forca më efektive për ndryshim. ABA do të punojë me dy organizatat pra SHGJK-në dhe OAK-në për të përmirësuar avokimin e tyre publik, shtrirje dhe zhvillim të lobimit dhe për të arritur një rol më aktiv dhe të dukshëm në diskurs ndër institucione të përfshira në sektorin e drejtësisë dhe avancimin e sundimit të ligjit.

ABA është e inkurajuar që Presidenti i SHGJK-së ka treguar entuziazëm për të krijuar një strukturë organizative dhe fokus më të fortë. Dy anëtarë të stafit të punësuar me orar të plotë – administratorja dhe drejtoresha e programit i sigurojnë një përkrahje shumë të nevojshme udhëheqësisë së SHGJK-së për të menaxhuar organizatën, projektet e saja dhe financat në baza ditore.

Transferimi i kompetencave gjyqësorit nga ana e UNMIK-ut tek institucionet lokale siç është Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe procesi i riemërimit të gjykatësve si dhe ristrukturimi i gjyqësorit i kanë ofruar SHGJK-së një mundësi të rrallë për të promovuar dhe shërbyer interesave të gjykatësve si një grup. Gjykatësit individual kanë qenë aktiv në këto procese por ata mund të jenë shumë kredibil dhe efektiv nëse shoqatat do të mblidheshin së bashku për të ndërmarrë pozita kolektive dhe aksion.

Bashkangjitur: Një-faqe; Pyetjet nga Intervista; Fletë pune; dhe Vlerësimi RIBA i vitit 2005.